

**CULTURAL PROPERTY**

**Agreement Between the  
UNITED STATES OF AMERICA  
and ALBANIA**

Signed at Washington July 12, 2004



NOTE BY THE DEPARTMENT OF STATE

Pursuant to Public Law 89—497, approved July 8, 1966  
(80 Stat. 271; 1 U.S.C. 113)—

“ . . .the Treaties and Other International Acts Series issued under the authority of the Secretary of State shall be competent evidence . . . of the treaties, international agreements other than treaties, and proclamations by the President of such treaties and international agreements other than treaties, as the case may be, therein contained, in all the courts of law and equity and of maritime jurisdiction, and in all the tribunals and public offices of the United States, and of the several States, without any further proof or authentication thereof.”

**ALBANIA**

**Cultural Property**

*Agreement signed at Washington July 12, 2004;  
Entered into force November 2, 2009.*

**AGREEMENT**  
**BETWEEN**  
**THE GOVERNMENT OF THE UNITED STATES OF**  
**AMERICA**  
**AND**  
**THE GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF ALBANIA**  
**ON**  
**THE PROTECTION AND PRESERVATION**  
**OF CERTAIN CULTURAL PROPERTIES**

The Government of the United States of America and the Government of the Republic of Albania, (hereafter referred to as Parties)

*Desirous* of successful mutual cooperation in the field of cultural heritage,

*Convinced* that such an agreement will contribute to the strengthening of numerous contacts between the two states,

*Bearing* in mind the respect due to fundamental human rights, and seeking to promote understanding, tolerance and friendship among all nations, racial and religious groups,

*Convinced* that each culture has a dignity and a value, which must be respected and preserved, and that all cultures form part of the common heritage belonging to all mankind,

*Desiring* to enhance the protection of cultural heritage and provide access to treasures of national and world culture without discrimination,

*Considering* that deterioration or disappearance of items of the cultural heritage constitutes an impoverishment of the heritage of all the nations of the world,

*Considering* that the protection of cultural heritage can be effective only if organized both nationally and internationally among states working in close cooperation,

*Considering* the principles of the Helsinki Final Act of the Conference on Security and Cooperation in Europe, and

*Desirous* of elaborating concrete steps in furtherance of the principles and purposes of the 1972 Convention for the Protection of the World Cultural and Natural Heritage with respect to certain items of cultural heritage of the victims of genocide,

*Have agreed as follows:*

#### ARTICLE 1

Each Party will take appropriate steps to protect and preserve the cultural heritage of all national, religious, or ethnic groups (hereafter referred to as "groups") that reside or resided in its territory, including victims of genocide during the Second World War.

The term "cultural heritage" for the purposes of this Agreement means places of worship, sites of historical significance, monuments, cemeteries, and memorials to the dead, as well as archival materials relating thereto.

#### ARTICLE 2

The Parties shall cooperate in identifying a list of appropriate items, which fall within the scope of Article 1, particularly those which are in danger of deterioration or destruction.

#### ARTICLE 3

Each Party will ensure that there is no discrimination, in form or in fact, against the cultural heritage of any group referred to in Article 1 or against the nationals of the other Party in the scope and application of its laws and regulations concerning:

- (a) the protection and preservation of their cultural heritage;
- (b) the right to contribute to the protection and preservation of their cultural heritage; and
- (c) public access thereto.

#### ARTICLE 4

In cases where a group concerned, referred to in Article 1, is unable, on its own, to ensure adequate protection and preservation of its cultural heritage, each Party shall take special steps to ensure such protection and preservation of cultural heritage within its territory and shall invite the cooperation of the other Party and its nationals where assistance is required for this purpose.

#### ARTICLE 5

Properties of cultural heritage, referred to in Article 4, that are of special significance shall be designated in a list of items of cultural heritage. Such a list shall be publicly announced and communicated to competent federal, state, and local authorities.

All properties of cultural heritage so designated shall be protected, preserved, and marked in the manner stipulated by valid legal internal regulations of either Party. Public access thereto shall be ensured.

Such a list of items of cultural heritage shall be designated by the Commission referred to in Article 6 hereof. The Commission may also designate properties for inclusion in the list at any time.

#### ARTICLE 6

A Joint Cultural Heritage Commission (JCHC) is hereby established to oversee the operations of a list referred to in Articles 2 and 5, and to perform such other functions as are delegated to it by the Parties. Each Party shall appoint one or more member(s) to the JCHC, who may be assisted by alternates and advisers. Decisions of the JCHC shall require the assent of all members. The Parties shall cooperate in supplying the JCHC with access to the items of cultural heritage and information necessary for the execution of its responsibilities.

Each Party through its representative on the JCHC referred to in the first paragraph hereof may request that special arrangements, as appropriate, be worked out under the procedures of the JHCH to protect and preserve the cultural heritage in the territory of the other Party of groups not covered under Article 1, in cases where such cultural heritage is associated with the cultural heritage abroad of citizens of the requesting Party and is in need for any reason of protection and preservation. The other Party will consider steps, within the scope of its laws and regulations, to respond to the request.

The United States Commission for the Preservation of America's Heritage Abroad shall be the Executive Agent for implementing this Agreement on the American side. Cultural Heritage Department in the Ministry of Culture, Youth and Sports of the Republic of Albania shall be the Executive Agent for implementing this Agreement on the Albanian side. Either Party may, by diplomatic note to the other, change the Executive Agent.

#### ARTICLE 7

Nothing in this Agreement shall be construed to relieve either Party of its obligations under the 1972 Convention for the Protection of the World Cultural and Natural Heritage or any other agreement for the protection of cultural heritage.

#### ARTICLE 8

This Agreement shall be implemented in accordance with the laws and regulations of both countries and the availability of funds.

#### ARTICLE 9

Disputes concerning the interpretation or application of this Agreement shall be submitted to the Agents referred to in the third paragraph of Article 6.


#### ARTICLE 10

This Agreement shall enter into force upon an exchange of diplomatic notes by which the Parties inform each other about the fulfillment of their respective legal requirements necessary for this Agreement's entry into force. It may be amended by mutual written agreement of the Parties.


This Agreement shall remain in force until terminated by either Party giving six months prior written notice through diplomatic channels to the other Party of its intention to terminate this Agreement.

DONE at Washington, on this 12 day of July 2004, in duplicate, in the English and Albanian languages, each text being ~~equally~~ authentic.

**FOR THE GOVERNMENT OF  
THE UNITED STATES OF AMERICA:**



**FOR THE GOVERNMENT OF  
THE REPUBLIC OF ALBANIA:**



# MARRËVESHJE

## MIDIS

### QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

## DHE

### QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

### PËR MBROJTJEN DHE RUAJTJEN

### PASURIVE TË CAKTUARA KULTURORE

Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë (që më poshtë do të referohen si Palë)

Me dëshirën për një bashkëpunim të suksesshëm reciprok në fushën e trashëgimisë kulturore;

Të bindur se një marrëveshje e tillë do të kontribuojë në forcimin e kontakteve të shumta midis të dy shteteve;

Duke mbajtur parasysh respektimin e të drejtave themelore të njeriut dhe duke dashur forcimin e mirëkuptimit, tolerancës dhe miqësisë midis të gjitha vendeve, grupeve racore dhe fetare;

Të bindur se çdo kulturë ka dinjitetin dhe vlerën e saj që duhet të respektohet dhe të ruhet dhe se të gjitha kulturat janë pjesë e trashëgimisë së përbashkët që i përket gjithë njerëzimit;

Duke dëshiruar të forcojnë mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe të sigurojnë hyrje në thesaret kombëtare dhe botërore pa diskriminim;

Duke marrë parasysh se rrënimi ose zhdukja e objekteve të trashëgimisë kulturore përbën varfërim të trashëgimisë së të gjitha kombeve të botës;

Duke marrë parasysh se mbrojtja e trashëgimisë kulturore mund të jetë e efektshme vetëm në rast se organizohet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, në bashkëpunim të ngushtë mes shteteve;

Duke marrë parasysh parimet e Aktit Përfundimtar të Helsinkit, të Konferencës për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë dhe Me dëshirën e ndërmarrjes së hapave konkrete për të thelluar më tej parimet dhe qëllimet e Konventës së vitit 1972 për Mbrojtjen e Trashëgimisë Botërore Kulturore dhe Natyrore, në lidhje me objekte të veçanta të trashëgimisë kulturore të viktimave të genocidit,



*bien dakord si vijon:*

## NENI 1

Secila Palë do të marrë masat e nevojshme për të mbrojtur dhe ruajtur trashëgiminë kulturore të të gjitha grupeve kombëtare, fetare dhe etnike (që këtu e më pas do të referohen si “grupe”) që jetojnë ose kanë jetuar në territorin e saj, përfshi dhe viktimat e genocidit gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Termi “trashëgimi kulturore”, i përdorur në këtë Marrëveshje kupton vendet e kultit, qëndrat me rëndësi historike, monumentet, varrezat dhe memorialet kushtuar të vdekurve si dhe materialet arkivore që lidhen me to.

## NENI 2

Palët do të bashkëpunojnë në identifikimin e listës së objekteve të duhura, që përfshihen brenda hapësirës së nenit 1, veçanërisht ato që rrezikohen të rrënohen ose shkatërrohen.

## NENI 3

Secila Palë do të sigurojë që të mos ketë diskrimin, de jure ose de fakto, kundër trashëgimisë kulturore të ndonjë grupi të referuar në nenin 1 ose kundër shtetasve të Palës tjetër brenda hapësirës dhe zbatimit të ligjeve dhe rregulloreve lidhur me:

- (a) mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë së tyre kulturore;
- (b) të drejtën për të kontribuar për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë së tyre kulturore; dhe
- (c) hyrjen e publikut në to.

## NENI 4

Në rastet kur nje grup i interesuar, qe permendet në nenin 1, nuk është në gjendje, vetëm për vetëm, të sigurojë mbrojtjen dhe ruajtjen e përshtashme të trashëgimisë së tij kulturore, secila Palë do të marrë masa të posaçme për të siguruar një mbrojtje dhe ruajtje të tillë të trashëgimisë kulturore brenda territorit të saj dhe të ftojë për bashkëpunim Palën tjetër dhe shtetasit e saj kur është e nevojshme një ndihmë e tillë për këtë qëllim.

## NENI 5

Pasuritë e trashëgimisë kulturore, të përmendura në nenin 4, që janë të një rëndësie të veçantë, do të hyjnë në listën e objekteve të trashëgimisë kulturore. Kjo listë do të shpallet publikisht dhe do t’iu komunikohet autoriteteve kompetente federale, shtetërore dhe lokale.

Të gjitha pasuritë e trashëgimisë kulturore, që përcaktohen si të tilla, do të mbrohen, ruhen dhe do të vendosen tabela sipas përcaktimeve në rregulloret e brendshme ligjore të vlefshme të secilës palë. Do të sigurohet hyrja e publikut në to.

Një listë e tillë e objekteve të trashëgimisë kulturore do të përcaktohet nga Komisioni të cilit i referohet neni 6 që vijon. Komisioni gjithashtu mund të përfshijë pasuri në këtë listë në çdo kohë.

## NENI 6

Një Komision i Përbashkët i Trashëgimisë Kulturore (KPTK) krijohet në mënyrë që të mbikëqyrë veprimet e listës së përmendur në nenet 2 dhe 5, dhe të kryejë funksione të tjera, siç i janë deleguar atij nga Palët. Secila Palë do të caktojë një ose disa anëtarë në KPTK, që mund të ndihmohen nga zëvendësat ose këshilltarët e tyre. Vendimet e KPTK-së do të kërkojnë miratimin e të gjithë anëtarëve. Palët do të bashkëpunojnë për t'i siguruar KPTK-së të drejtën për të parë objektet e trashëgimisë kulturore dhe informacionin e nevojshëm me qëllim që të zbatojë përgjegjësitë e veta.

Secila Palë nëpërmjet përfaqësuesit të saj në KPTK, që përmendet në paragrafin e parë sa më sipër, mund të kërkojë hartimin e rregulloreve të posaçme, si ta shikojë të përshtashme, sipas procedurave të KPTK-së për të mbrojtur dhe ruajtur trashëgiminë kulturore në territorin e Palës tjetër, të grupeve që nuk përfshihen në nenin 1, në rastet kur një trashëgimi e tillë kulturore është e lidhur me trashëgiminë kulturore jashtë vendit të shtetasve të Palës kërkuese dhe që ka nevojë, për arsye të ndryshme, të mbrohet dhe të ruhet. Pala tjetër do të konsiderojë hapat, brenda shtrirjes së ligjeve dhe rregulloreve të saj, për t'iu përgjigjur kësaj kërkesë.

Komisioni i Shteteve të Bashkuara për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore të Amerikës Jashtë do të jetë Agjenti Ekzekutiv për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje për Palën amerikane;

Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë do të jetë Agjenti Ekzekutiv për zbatimin e kësaj marrëveshjeje për Palën shqiptare. Secila Palë, me notë diplomatike të drejtuar tjetrës, mund të ndryshojë Agjentin Ekzekutiv.

## NENI 7

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të përpilohet për të liruar ndonjërin prej Palëve nga detyrimet e saj sipas Konventës së vitit 1972 për Mbrojtjen e Trashëgimisë Botërore Kulturore dhe Natyrore ose ndonjë marrëveshje tjetër për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

## NENI 8

Kjo Marrëveshje do të zbatohet në përputhje me ligjet dhe rregulloret e të dy vendeve dhe mundësinë e fondeve.

## NENI 9

Mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje do t'u paraqiten Agjentëve që përmenden në paragrafin e tretë të nenit 6.


## NENI 10

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas shkëmbimit të notave diplomatike me anë të së cilave secila Palë informon tjetrën për plotësimin e kërkesave ligjore përkatëse për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Ajo mund të ndryshohet me marrëveshje reciproke me shkrim nga Palët.

Kjo Marrëveshje do të qëndrojë në fuqi deri sa të zgjidhet nga njëra prej Palëve duke njoftuar me shkrim 6 muaj përpara, nëpërmjet kanaleve diplomatike, Palën tjetër për synimin e zgjidhjes së kësaj Marrëveshjeje.

Bërë në ..... më ...../..... 2004, në dy kopje, në gjuhën shqipe dhe angleze, secili tekst i njëjtë autentikisht.

**PËR QEVERINË E  
SHTETEVE TË BASHKUARA  
TË AMERIKËS**



**PËR QEVERINË E  
REPUBLICËS SË  
SHQIPËRISË**

